

LIGJ
Nr.7611, datë 23.9.1992

**PËR MIRATIMIN ME DISA SHTESA E NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.265, DATË
21.7.1992 "PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.7393, DATË 12.6.1990 "PËR
LËSHIMIN E PASAPORTAVE DHE DHËNIEN E VIZAVE"**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Të miratohet dekreti nr.265, datë 21.7.1992 "Për disa ndryshime në dekretin nr.7393, datë 12.6.1990 "Për lëshimin e pasaportave dhe dhënien e vizave", me këto shtesa e ndryshime:

Në nenin 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Të drejtën e mësipërme e kanë për reciprocitet edheshtetasit e atyre shteteve që nuk kërkojnë pajisjen me vizë tështetasve shqiptarë, kur këta të fundit hyjnë në territorin etyre".

Neni 2 ndryshohet si vijon:

Në nenin 18 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Shtetasit e shteteve anëtare të Komunitetit Evropian, të shteteve të EFTA-s, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasaë, Turqisë dhe Bullgarisë paguajnë një taksë për hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë, masa e së cilës përcaktohet me dispozita të veçanta".

Pas nenit 3 shtohet neni 3/a me këtë përmbajtje:

"Në nenin 16 shtohet ky paragraf:

T'u hiqen pasaportat diplomatike dhe të shërbimit të gjithë personave që nuk kryejnë më ato funksione, për të cilat ata janë pajisur me këto pasaporta".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.313, datë 7.10.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.